

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Evadimi i mbetjeve urbane ne S. U. “Shefqet Ndroqi”, Tiranë - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vite (24 muaj)”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
**90918000-5: Shërbime të Pastrimit të koshave të plehrave.**

**VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit/Vlera e pritshme e Kontratave: 9,907,560 (nëntë milion e nëntëqind e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.**

Nr.	Emertim	Njesi	Sasia e parashikuar per 24 muaj (kg)
1.	Evadim mbetjesh urbane	kg	569,400

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor S. U. ”Shefqet Ndroqi”, Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

1. **Kriteri 2.1.1:** Operatori ekonomik duhet të disponojë liçencë për ushtrimin e aktivitetit lidhur me objektin e Kontratës, (veprimtaria e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis) e lëshuar nga QKB, me **KOD III.2.A për “Sherbime ekspertize dhe /ose profesionale lidhur ndikimin në mjedis”, pasi këto veprimtari kanë ndikim në mjedis dhe KOD III.2.B për “Grumbullim dhe transportim të mbetjeve”.**

**Argumentimi per Kriter 2.1.1:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në mbështetje të ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011, ”Per mbrojtjen e mjedisit”, ”Per lejet e mjedisit” i ndryshuar, ligjit nr.9010, date 13.2.2003 “Per administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 10463, date 22.09.2011, ”Per menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 538, date 26.05.2009, ”Per licensat dhe lejet, që trajtohen nga/apo nepermjet QKB dhe disa rregullime të tjera nenligjore të perbashketa”, i ndryshuar.

Ky kriter është përcaktuar nga AK me qëllim që OE të ushtrojë veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi, nisur edhe nga fakti se janë mbetje urbane dhe paraqesin rrezikshmëri në mjedis në rast mosevadimi si duhet. (shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

## **2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**1. Pika 2.2.1:** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave kësaj Proçedure Prokurimi.

**Shënim\*:** Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera 20 % do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar/vlerës së pritshme të Kontratave për të cilën ofertohe.

**Nëse operatorët ekonomikë, në këtë procedurë prokurimi, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këtë DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Ne përputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, ”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne të cilin gjejmë të përcaktuar se:

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të

zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

---

Legjislatori në piken 1 dhe piken 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet se:

Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Referuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure AK ka menduar se vendosja e nje vlere minimale te xhiros jo me e vogel se **20 % e vlerës së fondit limit\***, për të cilë konkurron operatori, është një dëshmi e mjaftueshme për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomikë ofertues zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore **brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.**

Vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2021, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë afat deri më 31.03.2022.

(Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.).

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 "Mbi Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare**; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

Referuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure AK ka menduar se vendosja e nje vlere minimale te xhiros jo me e vogel se **20 % e vlerës së fondit limit.vlerës së pritshme të kontratave për të cilat konkurron operatori, eshte nje deshmi e mjaftueshme per te krijuar** bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomike ofertues zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK. Përcaktimi i nga AK i kesaj kerkese, lidhet me natyren sensitive te sherbimit ne kontekst te shendetit publik dhe mjedisit, ndaj nga OE kerkohen parametra te larte besueshmerie. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor per besueshmerine dhe qendrueshmerine e tij.

(Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.).

**Pika 2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare \_\_\_\_\_, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ..... (shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. (Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor).

**(nuk është i aplikueshëm)**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, \_\_\_\_\_ (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**1. Pika 2.3.1:** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate/vlerës së pritshme të kontratave.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Shënim\*:** Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera 20 % do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit/vlerën e prishtme të Kontratave për të cilën ofertohet.

*Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e madhe se 40% të vlerës së fondit limit/vlerës së pritshme të Kontratave, vlerë e cila është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Kjo kërkohet që OE të vërtetojnë aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK, referuar nenit 55 pika 4 germa b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

*“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.”*

Eshtë kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **minimumi 20% të fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave për të cilët oferton Operatori Ekonomik**, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës).

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkoet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

### **2.Kriteri 2.3.2:**

**a.)** Operatori duhet të ketë certifikatën **ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkoet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**b.)** Operatori, duhet të ketë certifikatën **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit”** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkoet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**c.)** Operatori, duhet të ketë certifikatën **ISO 45001:2018 (për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë) mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë”** në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkoet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentimi për Kriterin 2.3.2 pikat: a; b dhe c:** Me anë të këtij kriteri kërkoet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Në bazë të nenit 79/1, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe neneve 41/4/a si dhe 44/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkoet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma nderkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita, Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

**3.Kriteri 2.3.3:** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

Kërkoet që ofertuesi të paraqesë një vërtetim për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik për periudhën **tre muaj nga data e hapjes së ofertave**, numri i të cilëve të jetë minimumi 7 (shtatë) punonjës të nevojshëm

për realizimin e objektit të prokurimit, ndër të cilët dy nga punonjësit duhet të jenë minimumi: një inxhinjer mjedisi, 2 (dy) shofera për dy makina, dhe 4 (katër) punonjës mbështetës për ngarkimin/shkarkimin e mbetjeve), me qëllim realizimin me sukses të këtij Shërbimi.

Për këtë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata tatimore së bashku me listëpagesat sipas formularit E-SIG 025, ku te pasqyrohen minimumi 7 - shtatë punonjës për secilin muaj për periudhën e mësipërme dhe

-Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

▪ Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

• Minimumi 1 (një) Inxhinier Mjedisi, i trajnuar dhe i **pajisur me çertifikatë nga Ministria e Mjedisit për vlerësimin ne mjedis;**

– Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga stafi më sipër:

• CV përkatese;

• Kopje e noterizuar e diplomës së Universitetit;

• Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme ose Kontratë Shërbimi e lidhur me inxhinjerin e mjedisit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë personelin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (disponimin e punonjesve), OE fitues duhet të paraqesi dokumentacionin e përcaktuar më lart origjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”*

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar.kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

*Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

**Argumentimi pika 2.3.3:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

## Neni 41/4 b i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose**
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
- d) Në rastin e procedurës së prokurimit "Shërbim konsulence", stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Vendosja e këtij kriteri dhe përcaktimi kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

*Gjithashtu, inxhinjeri është vendosur të kërkohen nga AK me argumentimin se këto mbetje konsiderohen të një rrezikshmërie të veçantë dhe nevoja e inxhinjerit të trajnauar për grumbullimin dhe ndikimin e mbetjeve në Mjedi, nevojitet për të dëshmuar OE që i ka të gjitha kapacitetet dhe personat specialistë për evadimin e këtyre mbetjeve sipas legjislacionit në fuqi.*

*(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/ certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).*

**Pika 2.3.4:** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 7 persona**, punonjës të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë personelin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (disponimin e punonjesve), OE fitues duhet të paraqesi dokumentacionin e përcaktuar më lart orgjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: *"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin."*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Neni 41/4, pika c, i VKM nr. 285, datw 19.05.2021, i ndryshuar:

. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) **fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose**
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
- d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Vendosja e këtij kriteri dhe përcaktimi kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

minimumi 7 (shtatë) punonjës të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, ndër të cilët dy nga punonjësit duhet të jenë minimumi: një inxhinjer mjedisi, 2 (dy) shofera për dy makina, dhe 4 (katër) punonjës mbështetës për ngarkimin/shkarkimin e mbetjeve), me qëllim realizimin me sukses të këtij Shërbimi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë personelin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*(Shënim- Specifikoni proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës së shërbimit, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer).*

**Kriteri 2.3.5:** “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë *ne pronesi ose me qera minimalisht 2 (dy) mjete të tonazhit të rëndë që transportojnë mbetjet urbane, me kapacitet minimal koshi jo më të vogël se 7 ton, i mbyllur, i paisur me mekanizem ngrites fundor, i paisur me ndricim fundor dhe sinjalizues zanor.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

- Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:
  - Për automjetin në pronësi: *Aktin e pronësisë së mjetit, leje qarkullimi, akt - kolaudimi dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet, si dhe foto te mjeteve ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese, të përshtatshme për evadimin e mbetjeve urbane.*
  - Për automjetet që nuk janë në pronësi: *Kontratë qiraje të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit objekt prokurimi, si dhe leje qarkullimi, akt-kolaudim dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet, të përshtatshme për evadimin e mbetjeve urbane.*

**Argumentimi per Kriter 2.3.5:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Neni 41/4, pika c, i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar:

. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) **mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**

d) *Në rastin e procedurës së prokurimit "Shërbim konsulence", stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion automjetet për të përmbushur elementet e kontratës (transportin), të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu, nisur nga fakti se ky shërbim është çdo ditë, ose edhe dy herë në ditë, janë kërkuar dy makina për evadimin e mbetjeve urbane, me argumentimin se nëse pëson difekt një makinë ëhstë makina tjetër në dispozicion.

*(Shënim- shtoni argumentimin nga ana teknike për nevojën për mjetet dhe pajisjet e kërkuara, për realizimin e kontratës).*

*Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:*

#### **2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

1. **Pika 2.4.1:** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me nje landfill te autorizuar/licensuar per depozitimin e mbetjeve urbane, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme gjate kohëzgjatjes së Kontratave të lidhura me AK.

**Argumentimi Kriteri 2.4.1:** Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

*Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", duke qene se, ne baze te VendimittëKëshillit të Ministarve Nr.798, datë 29.9.2010 përmiratimin e rregullores "PërAdministrimin e MbetjeveSpitalore", AK si krijues i mbetjeve eshte pergjegjes deri ne hallken e fundit te asgjesimit te mbetjeve spitalore qe krijon, kerkon qe operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë të lidhur*

me landfill te licensuar per depozitimin e trajtimit/asgjesimit, e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Gjithashtu, ky kriter vendoset ne zbatim te vendimeve te Komisionit te Prokurimit Publik Nr.701 date 22.07.2022 si dhe Nr.751 date 04.08.2022, si edhe rekomandimeve te APP-se.

***Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.***

***Shënim:*** KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit si dhe do te verifikojë ne vend funksionimin e impianteve te paraqitura, duke asistuar realizimin e nje cikli pune nga seicili.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

***Shënim:*** Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

***Kujdes:*** Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

### **4. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

## **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të

hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

### **Specifikime teknike**

1. Operatori Ekonomik Fitues duhet të paraqitet sa herë merr njoftime nga Autoriteti Kontraktor, në bazë të nevojave të këtij të fundit.
2. Operatori ekonomik fitues duhet të sigurojë (sjelle) dhe 6 (gjashtë) kontenier plastike (te rinj) me kapacitet 130 kg secili për grumbullimin e mbetjeve urbane.
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të autorizuar/licensuar për depozitimin e mbetjeve urbane, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.
4. Operatori ekonomik fitues duhet që çdo ditë të bëjë evadimin e mbetjeve urbane nga ora 06:00 deri në ora 07:00.
5. Pas çdo evadimi duhet të bëjë dhe klorimin e ambientit të vendgrumbullimit të mbetjeve urbane.
6. Për të nxjerre sasinë e mbetjeve që do të evadohen në muaj nga OE, duhet të bëhen 3-4 sondazhe në çdo muaj, mesatarja e këtyre sondazheve shumezohet me ditët që ka muaji dhe del sasia totale e mbetjeve që do faturohet për muajin.
7. Peshimi i mbetjeve do të kryhet nga një peshorë e kolauduar nga Drejtoria e Meteorologjisë, që do të vihet në dispozicion nga ana e OE fitues.
8. Në fund të çdo sondazhi mbahet proces verbal në prani të përfaqësuesve të AK-se dhe OE-se për sasinë e mbetjeve që dolën nga peshimi.
9. Në fund të çdo muaji mbahet proces – verbal perfundimtar mes paleve dhe situacioni muajor.
10. Operatori duhet të ketë në pronësi /qira, minimalisht **2 (dy) mjete** të tonazhit të rëndë që transportojnë mbetjet urbane, me kapacitet minimal koshi jo më të vogël se 7 ton, i mbyllur, i paisur me mekanizëm ngrites fundor, i paisur me ndricim fundor dhe sinjalizues zanor. dhe për këtë të paraqesë dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë osë të marrjes me qira të mjeteve.
11. Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë për ushtrimin e aktivitetit lidhur me objektin e Kontratës, (veprimtaria e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis) e lëshuar nga QKB, me KOD III.2.A për “Shërbime ekspertize dhe /ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, pasi këto veprimtari kanë ndikim në mjedis dhe KOD III.2.B për “Grumbullim dhe transportim të mbetjeve”.

12. O E. duhet te kete Çertifikatë SSH/EN ISO 9001:2015 (sistemi menaxhimit te Cilesise)
13. OE . duhet te kete Çertifikate SSH/EN ISO 14001 : 2015 (sistemi menaxhimit te Mjedisit )
14. Çertifikate ose ISO 45001 : 2018 (per sistemin e menaxhimit te sigurise ne pune ).

Në Zbatim të të rekomandimit të APP dhe DPA datë 20.03.2018, të gjitha çertifikatat e cilësisë duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilësisë ,të akredituar nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika E Shqipërisë .

15. Operatori Ekonomik duhet ta ketë jo më pak se 7 persona të punësuar të siguruar për periudhen në 3 muaj nga data e hapjes së ofertave.

Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha shërbimeve. Për këtë operatori duhet të paraqesë dokumentacionin se ka punësuar dhe regjistruar në listpagesa minimalisht:

1 (një) Inxhinier Mjedisi, i trajnuar dhe i pajisur me çertifikatë nga Ministria e Mjedisit për vlerësimin ne mjedis;

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

## **FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Evadimi i mbetjeve urbane në S. U. "Shefqet Ndroqi", Tiranë.**

<b>Shërbimet</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma: Sasia e Parashikuar/24 muaj.</b>	<b>Vendi i ekzekutimit</b>	<b>Afati i ekzekutimit</b>
Evadim mbetjesh urbane	kg	569,400	SU " Shefqet Ndroqi" Tiranë	Sipas DST në 24 muaj

**Afatet e ekzekutimit: Nga data e nënshkrimit të MK, deri ne 2 vite (24 muaj), sipas nevojave të Autoritetit tonë Kontraktor.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### **TERMAT E REFERENCES**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Evadim i mbetjeve urbane, në S. U. "Shefqet Ndroqi", Tiranë"- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vjeçar (24 muaj)".

16. Detyrat: Operatori Ekonomik Fitues duhet të paraqitet sa herë merr njoftime nga Autoriteti Kontraktor, në bazë të nevojave të këtij të fundit.

17. Operatori ekonomik fitues duhet të sigurojë (sjelle) dhe 6 (gjashtë) kontenier plastike (te rinj) me kapacitet 130 kg secili për grumbullimin e mbetjeve urbane.

18. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të autorizuar/licensuar për depozitim të mbetjeve urbane, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.

19. Operatori ekonomik fitues duhet që çdo ditë të bëjë evadimin e mbetjeve urbane nga ora 06:00 deri në ora 07:00.

20. Pas çdo evadimi duhet të bëjë dhe klorinimin e ambientit të vendgrumbullimit të mbetjeve urbane.

21. Për të nxjerrë sasinë e mbetjeve që do të evadohen në muaj nga OE, duhet të bëhen 3-4 sondazhe në çdo muaj, mesatarja e këtyre sondazheve shumezohet me ditët që ka muaji dhe del sasia totale e mbetjeve që do faturohet për muajin.

22. Peshimi i mbetjeve do të kryhet nga një peshorë e kolauduar nga Drejtoria e Meteorologjisë, që do të vihet në dispozicion nga ana e OE fitues.

23. Në fund të çdo sondazhi mbahet proces verbal në prani të përfaqësuesve të AK-së dhe OE-së për sasinë e mbetjeve që dolën nga peshimi.

24. Në fund të çdo muaji mbahet proces – verbal i perfundimtar mes paleve dhe situacioni i muajit.

25. Operatori duhet të ketë në pronësi /qira, minimalisht **2 (dy) mjete** të tonazhit të rëndë që transportojnë mbetjet urbane, me kapacitet minimal koshi jo më të vogël se 7 ton, i mbyllur, i paisur me mekanizëm ngrites fundor, i paisur me ndricim fundor dhe sinjalizues zanor. dhe për këtë të paraqesë dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë ose të marrjes me qira të mjeteve.

26. Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë për ushtrimin e aktivitetit të lidhur me objektin e Kontratës, (veprimtaria e ekspertizës të lidhur me ndikimin në mjedis) e lëshuar nga QKB, me KOD III.2.A për “Shërbime ekspertize dhe /ose profesionale të lidhur me ndikimin në mjedis”, pasi këto veprimtari kanë ndikim në mjedis dhe KOD III.2.B për “Grumbullim dhe transportim të mbetjeve”.

27. O E. duhet të ketë Çertifikatë SSH/EN ISO 9001:2015 (sistemi i menaxhimit të cilësisë)

28. OE . duhet të ketë Çertifikatë SSH/EN ISO 14001 : 2015 (sistemi i menaxhimit të mjedisit )

29. Çertifikatë ISO 45001 : 2018 (për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë ).

Në Zbatim të rekomandimit të APP dhe DPA datë 20.03.2018 , të gjitha çertifikatat e cilësisë duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilësisë ,të akredituar nga DPA, ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika E Shqipërisë .

30. Operatori Ekonomik duhet ta ketë jo më pak se 7 persona të punësuar të siguruar për periudhën në 3 muaj nga data e hapjes së ofertave.

Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha shërbimeve. Për këtë operatori duhet të paraqesë dokumentacionin se ka punësuar dhe regjistruar në listpagesa minimalisht:

1 (një) Inxhinier Mjedis, i trajnuar dhe i pajisur me çertifikatë nga Ministria e Mjedisit për vlerësimin në mjedis;

**Shpërndarja:** do të realizohet në varësi të mbetjeve të prodhuara dhe të grumbulluara pranë Autoritetit Tonë Kontraktor, sipas muajve përgjatë 24 muajve dhe të ndara në tabelën më poshtë:

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma: Sasia e Parashikuar/24 muaj.	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
Evadim mbetjesh urbane	kg	569,400	SU “ Shefqet Ndroqi” Tiranë	Sipas DST në 24 muaj.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: **Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”,**  
**Adr.: Rr. “Dr/ Shefqet Ndroqi”, Sauk, Tiranë.**

Formulimi i specifikimeve, caktimi i sasive si dhe ndarja në lote është kryer nga personi përgjegjës, Specialist Fushe, ndërsa përlllogaritja e fondit limit është kryer nga personi përgjegjës i fushës së ekonomisë.

**Argumentimi:** Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP:

*“38/b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrimi i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **NJËSIA E PROKURIMIT**